



UNIVERSITETI • UNIVERSITY  
"KADRI ZEKA"

Universiteti Public "KADRI ZEKA" Public University			
Pranuar nga:	21-12-2020		
Numri i dokumentit:	01/	2265	



## MEMORANDUM MIRËKUPITIMI DHE BASHKËPUNIMI

në mes të

UNIVERSITETIT "KADRI ZEKA" GJILAN

dhe

HYMERI KLEEMANN

Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan (në tekstin e mëtejshëm UKZ), i përfaqësuar nga Rektori, Prof. Asoc. Dr. Bajram KOSUMI dhe HYMERI KLEEMANN sh.a., i përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Hysni YMERI, pajtohen të bashkëpunojnë në ngritjen profesionale të studentëve të UKZ-së, të ofrojë laboratorët e tyre për qëllime të përbashkëta, të rekrutojë stafin e ardhshëm mundësisht edhe nga studentët praktikant të KZ-së, të jetë bashkëpunëtorë i ngushtë i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike për krijimin e programeve të reja studimore, me interes të përbashkët, duke qenë partner serioz edhe gjatë proceseve të akreditimit të FSHK-së.

### I

#### Qëllimi i Memorandumit të Bashkëpunimit

Me qëllim të promovimit të bashkëpunimit në ngritjen profesionale të studentëve të UKZ dhe HYMERI KLEEMANN sh.a., me datën 21.12.2020 lidhin këtë Marrëveshje të Bashkëpunimit në mes të këtyre dy institucioneve, me të cilën HYMERI KLEEMANN do të pranojë një numër të caktuar të studentëve të UKZ-së që të kryejnë praktikën profesionale, atëherë kur HYMERI KLEEMANN ka hapësirë për angazhimin e studentëve në punë praktike.

### II

#### Detyrat dhe Përgjegjësitë e HYMERI KLEEMANN

- Caktimi i mentorit, gjegjësisht i udhëheqësve të punës të cilët do t'i udhëheqin studentët;
- Krijimi i kushteve të punës për këta studentë të cilët janë të obliguar të qëndrojnë në objektet e HYMERI KLEEMANN-it gjatë kohës së praktikës profesionale;
- Lejimin e qasjes në lokalet dhe informatat e HYMERI KLEEMANN në harmoni me politikat e kompanisë;
- Do të informoj studentët në praktikë profesionale mbi rregullat e punës dhe të sigurisë, rregullat e hyrjes-daljes, rregullat e konfidencialitetit dhe rregullat tjera relevante;
- Përgatitja dhe organizimi i programeve të punës praktike profesionale dhe përgatitja e raportit final nëse kërkohet nga UKZ;



UNIVERSITETI • UNIVERSITY  
"KADRI ZEKA"

Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Prilapsimi: 21-12-2020			
Numri i regjistrimit	Numri	Emri	Titulli
	011	2265	



- Informoj UKZ-në në rast të paraqitjes së ndonjë problemi në relacion me studentin në praktikë profesionale dhe informata tjera relevante;
- Dizajnimi i aktiviteteve javore për punë praktike të studentit;
- Të sigurojë që mentori, gjegjësisht udhëheqësi do të merr pjesë në prezantimin publik të punës së studentit-kandidatit nëse do të bëhet në UKZ.
- Të sigurojë se nuk do të pranojë në punë praktike studentë pa fletëudhëzimin - kontratën e punës praktike e cila është e nënshkruar nga koordinatori i punës praktike dhe e vulosur nga UKZ.
- HYMERI KLEEMANN në bazë të mundësive i paguan studentët për praktikën e tyre sipas rregulloreve të mbrendshme të kompanisë.

### III

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e Universitetit "Kadri Zeka" Gjiilan

- UKZ do të jetë përgjegjëse për përpilimin e listës së studentëve që do të kryejnë praktikën profesionale në HYMERI KLEEMANN;
- Të sigurojë një anëtarë të komisionit, nga fusha përkatëse, për mbrojtjen publike të prezantimit të punës praktike (nëse aplikoni);
- T'i informoj studentët në praktikë profesionale se duhet ti respektojnë politikat, procedurat e sidomos ato mbi sigurinë në punë, konfidencialitetin e informatave, etj;
- UKZ obligohet që pas kryerjes dhe prezantimit të suksesshëm të punës praktike, t'i akumulojë studentit numër të caktuar të ECTS/ kredi, në kuadër të lëndës PROJEKTI, sipas Rregullores për Studime Bachelor dhe Master në Fakultetin e Shkencave Kompjuterike.
- UKZ ka obligim të organizojë prezantimin publik të punës praktike para komisionit në përbërje të cilit marrin pjesë tre anëtarë: koordinatori i punës praktike, udhëheqësi i punës praktike nga HYMERI KLEEMANN dhe një anëtarë i komisionit nga fusha relevante që e cakton Fakulteti i Shkencave Kompjuterike i UKZ-së;
- UKZ ka për obligim që secilin student ta pajis me një fletëudhëzim, i cili do të përpilohet në bashkëpunim me HYMERI KLEEMANN dhe se në përfundim të praktikës studentët do të pajisen me një certifikatë të përbashkët, e nënshkruar nga dy institucionet partnere.

### IV

#### Fillimi dhe kohëzgjatja e praktikës profesionale

Praktika profesionale në harmoni me këtë marrëveshje të bashkëpunimit do të filloi të implementohet pas nënshkrimit nga UKZ dhe HYMERI KLEEMANN, ndërsaq data e fillimit do të caktohet nga HYMERI KLEEMANN varësisht prej krijimit të kushteve nga HYMERI KLEEMANN.

Kohëzgjatja e praktikës profesionale, gjegjësisht koha e qëndrimit të studentit në HYMERI KLEEMANN për kryerjen e praktikës profesionale është 120 orë, ose edhe më gjatë, sipas marrëveshjeve të veçanta.



UNIVERSITETI • UNIVERSITY  
"KADRI ZEKA"

Universiteti Publik "KADRI ZEKA" Public University			
Pranuar nga data: 21-12-2020			
Nëse pranuar nga:	Emri:	Titulli:	Llogaritja:
	011	2265	



## V

UKZ dhe HYMERI KLEEMANN pajtohen me të gjitha pikat e Memorandumit.

Përkitazi me detyrat dhe përgjegjësitë e mësipërme të këtij Memorandumi, secila palë nënshkruese duhet t'i bartë përgjegjësitë në fushën e detyrimeve dhe përgjegjësi të pranuar me këtë Memorandum, të cilat janë në harmoni me Ligjet pozitive në Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, palët nënshkruese do të mbajnë kontakte të përhershme për zbatimin e këtij Memorandumi.

Palët do të shkëmbejnë përvoja me interes të përbashkët dhe do të njoftojnë njëra-tjetrën me çdo kërkesë, vërejtje, sugjerim a propozim që ka të bëjë me realizimin e projektit sipas kushteve të këtij Memorandumi.

Palët për çfarëdo ndryshimi të kësaj Marrëveshje si dhe për çfarëdo paqartësie që do të mund paraqitet në të ardhmen, palët do të zgjidhin me mirëkuptim si dhe me Marrëveshje të veçantë.

## VI

Ky Memorandum i Mirëkuptimit hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e udhëheqësve (drejtuesve) të UKZ-së dhe HYMERI KLEEMANN-it, përkatësisht të përfaqësuesve të tyre të autorizuar e cila është valide që nga nënshkrimi i dy palëve.

Ky Memorandum i Mirëkuptimit është përgatitur në dy (2) kopje të njëjta, prej të cilave pasi të nënshkruhet dhe protokollohet, secila palë do të merr një (1) kopje.

PËR: UNIVERSITETIN "KADRI ZEKA", GJILAN		PËR: HYMERI KLEEMANN sh.a.	
Emri:	Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi	Emri:	Z. Hysni Ymeri
Pozita:	Rektor	Pozita:	Drejtor Ekzekutiv
Nënshkrimi/Vula:		Nënshkrimi/Vula:	
Data/ Vendi:	21/12/2020 Gjiilan	Data/ Vendi:	21/12/2020 Gjiilan

